

Vendim nr. 308, datë 26.11.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Illir Toska, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 26.11.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 42 (A) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ALEKSANDËR LEKA, përfaqësuar nga avokat Ariton Kasaj, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 243, datë 12.06.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë; nr. 2075 (30-2024-6372), datë 10.09.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2025-391, datë 06.03.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në lidhje me caktimin e masës së sigurimit “sekuestro preventive” mbi pasurinë nr. 267, datë 27.08.2020, të regjistruar në emër të kërkuarit.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 41, 42, 131, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi nëpërmjet kontratës së shitblerjes që mban datën 12.07.2020 ka blerë pasurinë e paluajtshme të llojit “tokë kullotë”, me sipërfaqe 10.000 m², të ndodhur në vendin e quajtur “Truve”, Himarë, të regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në datën 20.06.2020, përkundrejt çmimit 1.000.000 (një milion) lekë. Sipas kontratës, shitësi e ka përfituar këtë pasuri në cilësinë e pronarit të truallit në bazë të vendimit nr. 55, datë 03.03.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë (*neni 2 i kontratës*).

2. Ndërkohë, mbi bazën e tri kallëzimeve për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer më shumë se një herë, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186, paragrafi i dytë, 248 dhe 287 të Kodit Penal (KP), janë regjistruar tre procedime penale në ngarkim të disa personave, përfshirë edhe shitësin e pasurisë në fjalë. Të tria kallëzimet janë mbështetur në pretendimin se mbi bazën e falsifikimit të dokumenteve të pronësisë janë kryer veprime të paligjshme nga punonjësit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Vlorë për regjistrimin në regjistrat e pasurive të paluajtshme të disa parcelave tokë të ndodhura në Himarë. Duke qenë se këto kallëzime bënë fjalë për të njëjtin fakt penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (*Prokuroria e Vlorës*) ka vendosur bashkimin e të tria procedimeve penale në një të vetëm me nr. 51 të vitit 2021, për veprat penale të parashikuara nga nenet 186, paragrafi i dytë dhe 287 të KP-së.

3. Gjatë hetimeve ka rezultuar se fillimisht, në datën 24.05.2016, shitësi i pasurisë në fjalë i është drejtuar Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ATP) duke kërkuar njohjen e së drejtës së pronës, kthimin dhe kompensimin e pasurisë të ndodhur në Himarë, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të dy subjekteve të shpronësuara. Në kushtet kur shitësi (trashëgimtari ligjor) nuk ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga ATP-ja, kjo e fundit e ka kthyer kërkesën pa veprime, me argumentin se aktet dhe dokumentet e paraqitura nuk plotësonin kriteret formale. Kjo përgjigje është kundërshtuar gjyqësisht nga shitësi/trashëgimtari ligjor.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 55, datë 03.03.2020, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të ATP-së dhe njohjen e së drejtës së pronësisë trashëgimtarëve ligjorë të dy subjekteve të shpronësuara, si dhe kompensimin e pronës sipas përcaktimeve në dispozitiv. Në vendim gjykata ka specifikuar provat dhe dokumentacionin e administruar gjatë gjykimit, për të cilat është kërkuar konfirmimi nga institucionet shtetërore që kanë lëshuar këto akte. Kundër këtij vendimi është ushtruar

rekurs nga ATP-ja, Avokatura e Shtetit dhe ASHK-ja. Ndërkohë, pas 3 muajve nga dhënia e tij, vendimi është regjistruar në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme në datën 22.06.2020.

5. Nga aktet e dosjes gjyqësore, ku është administruar edhe dokumentacioni i pronësisë nga ASHK-ja, ka rezultuar se pas regjistrimit të pronës është bërë edhe transkriptimi i saj në emër të trashëgimtarëve ligjorë të subjekteve të shpronësuara, ku mbi njëzën nga pjesët e ndara është pasqyruar regjistrimi i kontratës së shitblerjes të datës 12.07.2020 dhe deklarata noteriale e datës 19.12.2022 në emër të kërkuesit.

6. Po kështu, nga korrespondenca e prokurorisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave ka rezultuar se dokumenti arkivor “dëshmi posedimore” F.694, V.1943, D.129, fl. 88, në emër të një prej subjekteve të shpronësuara, që është paraqitur në cilësinë e provës gjatë gjyqimit, nuk ekziston në arkiv. Sipas dosjes gjyqësore, dokumenti “dëshmi posedimore” është paraqitur nëpërmjet vërtetimit njësim me origjinalin i noterizuar dhe akti nuk është paraqitur gjatë shqyrtimit administrativ të kërkesës në ATP. Gjithashtu, edhe shkresa e datës 29.07.2005, me lëndë “kthim përgjigje për të dhëna pronësie shtetasit I.J.”, nuk ekziston. Në këto rrethana, në datën 09.06.2024 Prokuroria e Vlorës i ka konsideruar këto akte të falsifikuara dhe ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive ndaj pasurive të paluajtshme të regjistruara në emër të subjekteve të shpronësuara dhe trashëgimtarëve të tyre, përfshirë edhe pasuritë mbi të cilat ishin kryer transaksione si dhurime e shitje, me argumentin e mosrëndimit dhe zgjatjes së pasojave të veprës penale, pasi ekziston rreziku potencial që pronat të vazhdojnë të tjetërsohen ose të lidhen kontrata të tjera për zhvillimin e tyre.

7. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr. 243, datë 12.06.2024 (i ndrequr me vendimin nr. 304, datë 09.07.2024), ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe vendosjen e masës së sekuestros preventive, me argumentin se ka dyshime që pasuritë janë produkt i veprës penale të parashikuar nga neni 186, paragrafi i dytë, i KP-së. Ndonëse kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga kërkuesi dhe të tjerë, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 2075 (30-2024-6372), datë 10.09.2024, ka miratuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Ajo gjykatë ka argumentuar, ndër të tjera, se pasuria e trajtuar me vendimin civil të gjykatës së apelit është regjistruar në kundërshtim me ligjin, pasi kundër atij vendimi është ushtruar rekurs dhe mbi pasurinë janë kryer veprime për tjetërsimin e saj (dhurim, shitje dhe planifikohet zhvillimi i pronës). Po kështu, edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-391, datë 06.03.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi dhe të tjerë, si të pambështetur në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

8. Në datën 12.09.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim

kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 17.09.2025.

II

Pretendimet e kërkuetit

9. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

- 9.1. *Të drejtën e pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi pasuria e sekuestruar është blerë me kontratë të rregullt shitblerje. Kjo pasuri ka qenë e regjistruar në emër të shitësit përpara veprimeve të kryera me vendimin e gjykatës së apelit. Kërkueti nuk është i dyshuar për kryerjen e ndonjë vepre penale, nuk ka dyshime që veprimi juridik i kalimit të pronësisë të ketë qenë fiktiv, si dhe pranohet që kalimi i pronësisë është kryer me kundërshtpërblim, si dhe është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Kërkuetit i është kufizuar një nga tagrat e së drejtës së pronës, e drejta e disponimit lirisht të sendit të tij. Prona e kërkuetit nuk është pasqyruar në dokumentin e dyshuar si të falsifikuar, por në dokumentet e tjera që prokuroria i ka konfirmuar si të vërteta në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave. Gjykatat nuk kanë arsyetuar lidhjen e pronës së blerë prej tij me faktin penal të pretenduar, detyrim ky i nenit 274 të KPP-së. Gjykata e Lartë duhet të verifikonte nëse ndërmjet pronës së blerë nga kërkueti dhe dokumentit që pretendohet si i falsifikuar ka lidhje të drejtpërdrejtë, me qëllim vërtetimin e dyshimit të arsyeshëm për ekzistencën e faktit penal dhe lidhjes së pasurisë me faktin penal. E drejta e pronës ka rrjedhur nga një vendim i formës së prerë, i cili nuk mund të vlerësohet nga gjykatat në procesin penal, por vetëm me rekurs nga palët në Gjykatën e Lartë ose me rishikim. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nuk ka kthyer përgjigje që nuk ekziston dokumenti i vitit 1943, por referenca në shkresën përcjellëse mund të jetë e gabuar dhe ka kërkuar kopjen e dokumentit që ta kërkojë, ndërkohë që akti nuk është dërguar nga prokuroria. Po kështu, sipas shkresës përcjellëse, akti i vitit 2005 nuk është ruajtur për shkak të kalimit të afatit 5-vjeçar të ruajtjes.
- 9.2. *Parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit*, pasi gjykata e apelit ka rënduar pozitën e ankuesit, duke qenë se mbi bazën e ankimit të tij ka ndryshuar cilësimin e faktit penal, për të cilin është kërkuar masa e sigurimit pasuror, duke shtuar një akuzë të re, atë të shpërdorimit të detyrës, e cila, ndryshe nga sa ka arsyetuar ajo gjykatë, është hetuar,

verifikuar dhe ka rezultuar se fakti nuk përbënte vepër penale. Ndërkohë që gjykata e shkallës së parë nuk e ka mbështetur masën e sekuestros për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Kjo ka sjellë për pasojë cenimin e *së drejtës së ankimit*, pasi ai nuk ka pasur mundësi të paraqiste kundërshtime të tjera, duke iu ezauruar për këtë shkak një shkallë gjykimi.

9.3. *Parimin e sigurisë juridike*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal të vetë asaj gjykate dhe i ka hequr fuqinë juridike një vendimi gjyqësor pa ndjekur procedurën e rregullt ligjore. Gjykata e Lartë është shprehur dhe ka dhënë konkluzione për një vendim civil të formës së prerë nëpërmjet rishikimit të tij në tejkalim të kompetencave të gjykatës penale dhe hierarkisë gjyqësore, duke cenuar edhe *parimin e gjësë së gjykuar*. Nëse prona është përfituar nëpërmjet falsifikimit, këtë nuk mund ta përcaktojë gjykata e shkallës së parë, por një gjykatë e të njëjtit nivel me atë që ka dhënë vendimin civil që ka sjellë pasoja juridike. Gjykata e Lartë e ka bërë të panevojshëm në të ardhmen rishikimin e atij vendimi, duke u hequr mundësinë palëve civile të mbrohen ose të debatojnë në lidhje me këto konkluzione.

9.4. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet gjyqësore janë të paarsyetuara, por ato kanë kopjuar kërkesën e prokurorisë së bashku me materialet dhe pasaktësitë në tekst. Gjykatat nuk kanë verifikuar vërtetësinë e kërkesës së prokurorisë, pasi rrethanat e pasqyruara nuk janë të vërteta dhe ka qenë detyrë e tyre të mbështeten vetëm në aktet që ndodhen në dosjen gjyqësore. Ndryshe nga sa arsyetojnë gjykatat në dosjen gjyqësore, nuk është përdorur dhe nuk ekziston ndonjë shkresë me emërtimin “dëshmi posedimore”. Prokuroria nuk e ka verifikuar të gjithë dokumentacionin arkivor të depozituar nga ish-pronari në gjykimin civil. Gjykata e Lartë dukshëm nuk ka shqyrtuar shkaqet e ngritura në rekurs dhe nuk ka lexuar as rekursin, as dosjen gjyqësore. Masa e sekuestros preventive është vendosur pasi është mbyllur hetimi që ka zgjatur 3 vjet dhe ajo nuk është sekuestro konservative, sikurse shprehet ajo gjykatë. Kërkuesi në rekurs nuk ka ngritur pretendime për vlerësimin e gabuar të provave, por për mungesën tërësore të vlerësimin të provave, pasi mungon tërësisht arsytimi në vendimet gjyqësore që kanë kufizuar të drejtën e pronës. Vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor, ndërsa gjetjet e gjykatave mund të konsiderohen arbitrare ose të paarsyeshme, duke e bërë gjykimin të padrejtë.

III Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi është subjekt i cili mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji konstaton se kërkuari legjitimohet në aspektin procedural, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues.

12. Për sa i takon aspektin substancial, Kolegji vëren se kërkuari ka pretenduar, ndër të tjera, edhe cenimin e *parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit*, pasi gjykata e apelit ka rënduar pozitën e ankuesit, duke qenë se mbi bazën e ankimit të tij ka ndryshuar cilësimin e faktit penal, për të cilin është kërkuar masa e sigurimit pasuror, duke shtuar një akuzë të re, e cila, ndryshe nga sa ka arsyetuar ajo gjykatë, është hetuar, verifikuar dhe ka rezultuar se fakti nuk përbënte vepër penale të shpërdorimit të detyrës.

13. Në jurisprudencën kushtetuese parimi i mosrëndimit të pozitës së palës që vë në lëvizje gjykatën me ankim, i njohur si *reformatio in peius*, është parë në këndvështrim të garantimit të të drejtave të të pandehurit në procesin penal. Ky rregull është i parashikuar në mënyrë të shprehur në KPP dhe e ndalon gjykatën që të caktojë një dënim më të rëndë nga ai i caktuar me vendimin e

kundërshtuar kur apelues është vetëm i pandehuri (*shih vendimet nr. 15, datë 22.07.2008; nr. 13, datë 15.04.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji vë në dukje se argumentet e kërkuetit, në thelb, kanë të bëjnë me rëndimin e pozitës penale të të pandehurit/pandehurve, që në rastin konkret janë shitësi i pasurisë, i cili është akuzuar se ka falsifikuar dokumentet përmes të cilave ka arritur të regjistrojë pronën në emër të trashëgimlënësve të tij dhe pas kalimit në emër të tij përmes dëshmisë së trashëgimisë ia ka shitur atë kërkuetit, si dhe punonjësit e kadastrës që kanë kryer veprime për regjistrimin e pronës në kundërshtim me ligjin. Nga ana tjetër, sekuestrimi i pasurisë ka për qëllim parandalimin dhe shmangien e mundësive që pasuria të mund të tjetërsohet dhe në këtë mënyrë të rëndojë ose të zgjasë pasojat e veprës penale, ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të reja. Për rrjedhojë, për këtë pretendim kërkueti nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi nuk ka provuar interesin e tij të drejtpërdrejtë.

15. Për sa u takon pretendimeve të tjera që lidhen me të drejtën e pronës dhe të procesit të rregullt ligjor, Kolegji çmon se kërkueti legjitimohet *ratione personae* edhe në aspektin substancial, pasi pasuria e sekuestruar është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të tij përmes kontratës së shitblerjes së saj.

16. Lidhur me *kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive*, në rastin konkret objekt kundërshtimi janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit, të cilat kanë lënë praktikisht në fuqi masën e sekuestrimit preventiv ndaj pasurisë së paluajtshme të kërkuetit. Këto lloj vendimesh Gjykata i ka konsideruar përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues, me arsyetimin se ato, ndonëse janë me karakter të përkohshëm dhe nuk vendosin për themelin e çështjes, ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Kolegji çmon se kërkueti e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion.

17. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 06.03.2025, ndërsa i është dërguar avokatit të kërkuetit në rrugë elektronike në datën 29.05.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 12.09.2025. Në këto rrethana, ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit 4-mujor nga disponimi i vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Lartë, rrjedhimisht kërkueti legjitimohet edhe *ratione temporis*.

18. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkueti ka pretenduar, ndër të tjera, se masa e sekuestrimit të pasurisë së tij ka cenuar *parimin e sigurisë juridike*, mbështetur në dy shkaqe kryesore:

së pari, vendimi i Gjykatës së Lartë është në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal të vetë asaj gjykate dhe *së dyti*, i ka hequr fuqinë juridike një vendimi gjyqësor të formës së prerë pa ndjekur procedurën e rregullt ligjore, pasi është shprehur dhe ka dhënë konkluzione për një vendim civil nëpërmjet rishikimit të tij në tejkalim të kompetencave të gjykatës penale dhe hierarkisë gjyqësore, duke cenuar edhe *parimin e gjësë së gjykuar*. Sipas kërkuarit, nëse prona është përfituar nëpërmjet falsifikimit, këtë nuk mund ta përcaktojë gjykata e shkallës së parë, por një gjykatë e të njëjtit nivel me atë që ka dhënë vendimin civil që ka sjellë pasoja juridike. Gjykata e Lartë, ka argumentuar kërkuari, e ka bërë të panevojshëm në të ardhmen rishikimin e atij vendimi, duke u hequr mundësinë palëve civile të mbrohen ose të debatojnë në lidhje me këto konkluzione.

19. Gjykata ka theksuar se sekuestro preventive synon të ndërpresë pasojat e veprës penale në pikëpamje të rëndimit ose të zgjatjes së tyre, ose të parandalojë kryerjen e veprave penale të reja, si dhe të garantojë efektivitetin e një konfiskimi të mundshëm të mëvonshëm, duke bërë paraprakisht të padisponueshme, në një fazë që i paraprin dënimit, sendet që kanë shërbyer ose kanë qenë të destinuara për të kryer veprën penale, produktet e saj ose të ardhurat apo sendet, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbën veprën penale (*shih vendimin nr. 20, datë 11.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, masa e sekuestros në vetvete nuk vendos se kujt i përket e drejta e pronës (*shih vendimin nr. 33, datë 20.05.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji evidenton se lidhur me shkakun se vendimi i Gjykatës së Lartë është në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal të vetë asaj gjykate, nga përmbajtja e ankimit kushtetues nuk rezulton që vendimet e referuara nga kërkuari të jenë njësuere për praktikën gjyqësore dhe që vendimi i kundërshtuar ta ketë ndryshuar atë. Nga ana tjetër, për sa i takon shkakut që lidhet me cenimin e gjësë së gjykuar, Gjykata ka pohuar se siguria juridike nënkupton se kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim (*shih vendimet nr. 10, datë 13.02.2017; nr. 23, datë 08.06.2007 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar kur zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve në mënyrë përfundimtare (*shih vendimin nr. 12, datë 17.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kontekst, vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, për sa ajo ka disponuar, është i formës së prerë në kuptim të fuqisë ekzekutive (për sa kohë nuk ka një vendim të Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit të tij), por pavarësisht kësaj, ai nuk përbën një vendim përfundimtar me fuqinë e gjësë së gjykuar (*res judicata*), për sa i përket zgjidhjes në themel të mosmarrëveshjes mes palëve, për sa kohë që pala e paditur (ATP-ja, Avokatura e Shtetit dhe ASHK-ja) ka përdorur mjetet e zakonshme të ankimit (rekurs), duke e bërë në këtë mënyrë Gjykatën e Lartë kompetente për të shqyrtuar çështjen dhe për të

vendosur përfundimisht në lidhje me të. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk qëndron.

21. Për sa u përket pretendimeve të tjera që lidhen me cenimin e *së drejtës së pronës dhe të procesit të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit*, Kolegji sjell në vëmendje se kur kontrollohen vendimet që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm, pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual analizohen në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale. Në këtë kuptim, kontrolli kushtetues ushtrohet për disa aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 74, datë 22.10.2024; nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, nga ana tjetër, ka pohuar se në bazë të parimit të subsidiaritetit, u takon gjykatave të zakonshme që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën kushtetuese dhe evropiane në lidhje me parimin e proporcionalitetit, duke qenë ajo mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson t'i shqyrtojë pretendimet e kërkuarit në këndvështrim të së drejtës substanciale të pronës private të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe kriterëve kushtetuese që lejojnë kufizimin e saj, bazuar në arsytimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës private

23. Kërkuarisi ka argumentuar se pasuria e sekuestruar është blerë me kontratë të rregullt shitblerjeje. Kjo pasuri ka qenë e regjistruar në emër të shitësit përpara veprimeve të kryera me vendimin e gjykatës së apelit. Ai nuk është i dyshuar për kryerjen e ndonjë vepre penale, nuk ka dyshime që veprimi juridik i kalimit të pronësisë të ketë qenë fiktiv, si dhe pranohet që kalimi i pronësisë është kryer me kundërshtpërblim, si dhe është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Sipas kërkuarit, atij i është kufizuar një nga tagrat e së drejtës së pronës, e drejta e disponimit lirisht të sendit të tij. Prona e tij nuk është pasqyruar në dokumentin e dyshuar si të falsifikuar, por në dokumentet e tjera që prokuroria i ka konfirmuar si të vërteta në drejtorinë e arkivave. Gjykata e Lartë duhet të verifikonte nëse ndërmjet pronës së blerë nga kërkuarisi dhe dokumentit që pretendohet si i falsifikuar ka lidhje të drejtpërdrejtë, me qëllim vërtetimin e dyshimit të arsyeshëm për ekzistencën e fakti penal dhe lidhjes së pasurisë me faktin penal. E drejta e pronës ka

rrjedhur nga një vendim i formës së prerë, i cili nuk mund të vlerësohet nga gjykatat në procesin penal, por vetëm me rekurs nga palët në Gjykatën e Lartë ose me rishikim. Vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor, ndërsa gjykatat e faktit kanë kopjuar kërkesën e prokurorisë së bashku me materialet dhe pasaktësitë dhe janë shprehur se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova që pasuria e blerë nga kërkuesi rrjedh nga përdorimi i një dokumenti të falsifikuar. Ato nuk kanë arsyetuar lidhjen e pronës së blerë prej tij me faktin penal të pretenduar, detyrim ky i nenit 274 të KPP-së. Prokuroria nuk ka verifikuar të gjithë dokumentacionin arkivor të depozituar nga ish-pronari në gjykimin civil. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nuk ka kthyer përgjigje që nuk ekziston dokumenti i vitit 1943, por referenca në shkresën përcjellëse mund të jetë e gabuar dhe ka kërkuar kopjen e dokumentit që ta kërkojë, ndërkohë që akti nuk është dërguar nga prokuroria dhe shkresa përcjellëse e vitit 2005 nuk është ruajtur për shkak të kalimit të afatit 5- vjeçar të ruajtjes. Gjykatat nuk kanë dhënë argumente të mjaftueshme për ekzistencën e interesit publik në sekuestrimin e pronës së kërkuesit. Gjetjet e gjykatave mund të konsiderohen arbitrare ose të paarsyeshme, duke e bërë gjykimin të padrejtë.

24. E drejta e pronës private, e sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës, përfshin tre garanci që duhet të zbatohen në shqyrtimin e pretendimeve për cenimin e saj: *garancia e parë* ka të bëjë me parimin e gëzimit të qetë të pronës, e cila ka natyrë të përgjithshme; *garancia e dytë* ka të bëjë me kufizimet e lejueshme për të drejtën e pronës; *garancia e tretë* ka të bëjë me të drejtën e autoriteteve publike për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 53, datë 31.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në jurisprudencën kushtetuese është pranuar se ndërhyrja që vendimi i sekuestrimit bën tek e drejta e pronës: duhet të jetë *i ligjshëm*, në kuptimin që të jetë vendosur me ligj; të ndjekë një qëllim të ligjshëm, në kuptim të interesit publik; dhe të vendosë një “*ekuilibër të drejtë*” midis interesit publik dhe së drejtës së pronës së individit, në kuptimin që midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme *proporcionaliteti*. Dyshimi i arsyeshëm është i pranueshëm në fillim të hetimeve penale si bazë për ndërhyrje në të drejtën e pronës, megjithatë në vijim hetimet duhet të jenë të shpejta, në mënyrë që ndërhyrja të zgjasë për një kohë të kufizuar. Masat e përkohshme të vendosura në kuadër të procedurave gjyqësore, të cilat i paraprijnë një konfiskimi të mundshëm, mund të shkaktojnë dëmtim të pronës, por në mënyrë që dëmi të jetë në përputhje me garancitë kushtetuese, ai nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme (*shih vendimet nr. 33, datë 20.05.2025; nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se nga të dhënat e mbledhura nga prokuroria është krijuar dyshimi se disa parcela toke të ndodhura në Himarë janë regjistruar në emër

të disa shtetasve, pronarë të shpronësuar dhe trashëgimtarëve ligjorë të tyre, mbi bazën e një vendimi të gjykatës së apelit, e cila është mbështetur në disa akte që dyshohet se janë të falsifikuara. Po kështu, ndonëse kundër vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs nga institucionet shtetërore që kanë qenë palë të paditura në procesin civil, vendimi është regjistruar dhe mbi këto pasuri janë kryer transaksione me qëllim zhvillimin ekonomik të pronës. Ndërkohë, masa e sekuestros preventive është vendosur nga gjyqtari i shkallës së parë mbi kërkesën e prokurorit, ndërsa vendimi i tij në vijim i është nënshtruar kontrollit nga gjykatat më të larta, të cilat praktikisht e kanë lënë në fuqi masën e sigurimit pasuror. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se vendimet gjyqësore, të kundërshtuara, kanë ndërhyrë në të drejtën e pronës së kërkuarit, ndaj duhet analizuar nëse kjo ndërhyrje është bërë *vetëm me ligj, për interes publik ose për arsye të rëndësishme publike dhe nëse respekton kriterin e proporcionalitetit.*

27. Kolegji konstaton se vendimet gjyqësore të kundërshtuara përmbajnë informacionin në lidhje me arsyet e vendosjes të masës së sekuestrimit mbi pasurinë e paluajtshme, pasi, sipas gjykatave, regjistrimi në regjistrat e pasurive të paluajtshme është bërë në kundërshtim me ligjin, duke sjellë për rrjedhojë dyshimin se janë konsumuar elementet e veprave penale të falsifikimit, pastrimit të produkteve të veprës penale dhe shpërdorimit të detyrës.

28. Konkretisht, sipas gjykatës së shkallës së parë, plotësohen kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 274, pika 2, të KPP-së dhe nenin 36, pika 1, shkronja “b”, të KP-së, për vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë objekt gjykimi. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, sekuestroja preventive do të vendoset ndaj pasurive, përfshirë edhe atë në pronësi të kërkuarit, pasi ka dyshime të arsyeshme se është produkt i veprave penale të falsifikimit të dokumenteve. Sipas gjykatës, krijohen dyshime se disponimi i lirë i saj së bashku me pasuritë e tjera mundet të rëndojë ose të zgjasë më tepër pasojat e veprës penale ose mundet të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale, sepse rezulton se janë lidhur dhe nënshkruar disa kontrata shitjeje dhe dhurimi, si dhe sipërmarrje për ndërtim (*shih paragrafët 12 dhe 12.1 të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë*). Gjithashtu, gjykata e apelit ka analizuar nenin 274 të KPP-së dhe nevojën e vendosjes së sekuestros preventive mbi këto pasuri, edhe në referim të elementeve të veprës penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Vendimi civil i gjykatës së apelit është bazuar në dispozitat e ligjit për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave, sipas të cilit regjistrimi i vendimit të gjykatës së apelit, në rastin e shqyrtimit të ankimit kundër vendimit të ATP-së, nuk është i menjëhershëm, pasi ai mund të regjistrohet vetëm nëse është bërë përfundimtar, pra nëse ndaj tij nuk është ushtruar e drejta e rekursit ose kur Gjykata e Lartë e ka lënë atë vendim në fuqi. Kundër vendimit civil të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs, për rrjedhojë çdo veprim për

regjistrimin e pasurive të përfituara mbi bazën e këtij vendimi është në kundërshtim me ligjin. Në fashikullin penal të procedimit nr. 51 të vitit 2021 është printuar nga sistemi informacioni, sipas të cilit në datën 16.11.2021 është regjistruar në atë gjykatë për shqyrtim rekursi kundër atij vendimi. Referuar rrethanave të faktit, sipas gjykatës së apelit, provohet se jo vetëm është regjistruar pasuria e trajtuar me vendimin civil të gjykatës së apelit, por edhe janë kryer veprime tjetërsimi mbi këto pasuri si dhurim, shitje dhe planifikohet zhvillimi i pronës (*shih faqet 21 – 22 të vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm*). Ky vlerësim është gjetur i drejtë nga Gjykata e Lartë, e cila e ka lënë të pacenuar vendimmarrjen e gjykatës së apelit, pasi sipas saj, në zbatim të nenit 152 të KPP-së, ajo ka vlerësuar dhe analizuar provat në tërësi dhe në lidhje me njëra-tjetrën, duke mos paracaktuar dhe mbivlerësuar asnjë provë. Sipas Gjykatës së Lartë, argumenti që ngre rekursuesi, se kjo sekuestro ka cenuar edhe persona të cilët e kanë blerë sendin në mënyrë të rregullt, është një tregues se vijimi në gjendje të lirë i sendit do të zgjasë pasojat, duke përfshirë blerës të tjerë të rinj. Po kështu, ka argumentuar ajo gjykatë, nga hetimi konstatohet dhe motivohet se me sendet janë duke u kryer veprime të cilat e transferojnë atë tek të tretë dhe se përdorimi i dokumenteve të falsifikuara, të cilat kanë çuar gjykatën civile në një vendimmarrje të gabuar, janë rrethana të cilat janë të mjaftueshme për të mbështetur kërkimin për të vendosur masën e sekuestros, e cila është një masë e përkohshme, që i shërben hetimit dhe përfundimi i saj do të përcaktohet nga rezultati i hetimit. Po kështu, ka argumentuar Gjykata e Lartë, lidhur me pretendimin se kërkuesit i është rënduar pozita prej gjykatës së apelit, e cila ka përmendur një formë të konsumimit të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i KP-së për punonjësit shtetërorë, duhet të trajtohet si orientim për organin e prokurorisë në dobi të hetimit. Ajo gjykatë ka sjellë në vëmendje se gjykata e apelit vepron si një gjykatë e hetimit paraprak, e cila nuk mund të urdhërojë prokurorinë në kryerjen e veprime hetimore, por është për të kontrolluar kërkimet e prokurorisë në dobi të hetimit dhe në rastin konkret e ka orientuar atë. Sipas Gjykatës së Lartë, fakti që konkluzionet e gjykatës së apelit nuk përputhen me pretendimet e kërkuesit, nuk do të thotë se vendimi i rekursuar është i paarsyetuar (*shih paragrafët 29 – 31 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

29. Duke iu referuar arsytimit të vendimeve të gjykatave të zakonshme, Kolegji çmon se sekuestro preventive ndaj pasurisë është vendosur në përputhje me ligjin dhe për interesin publik – atë të mbarëvajtjes së procedimit penal, ku ky i fundit zhvillohet për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike nga veprat penale. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit se sekuestro është e paligjshme, pasi ai vetë nuk është i dyshuar për kryerjen e ndonjë vepre penale, nuk qëndron.

30. Për sa i takon proporcionalitetit, Kolegji vëren se gjykatat e zakonshme kanë analizuar nevojën, përshtatshmërinë dhe ashpërsinë e masës. Ato kanë vënë në dukje se ekziston rreziku se

disponimi i lirë i pasurisë së bashku me pasuritë e tjera mundet të rëndojë ose të zgjasë më tepër pasojat e veprës penale ose mundet të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale, pasi rezulton se janë lidhur dhe nënshkruar kontrata shitjeje dhe dhurimi, si dhe sipërmarrje për ndërtim, ndaj vendosja e masës së sekuestros preventive është bërë me qëllim që të pengohet çdo transferim i mundshëm deri në përfundimin e procesit penal në kuadër të të cilit është marrë kjo masë.

31. Në analizë të rrethanave të rastit në shqyrtim, Kolegji vë në dukje se masa e sekuestros preventive passjell kufizim të përkohshëm të disponimit të lirë të pasurisë, ndaj ekuilibri i duhur mes interesit publik dhe mjetit të përdorur është domethënës në ushtrimin e së drejtës së pronës, gjë e cila u imponon organeve gjyqësore të ndërmarrin veprime të shpejta dhe efektive. Thënë kjo, masa e sekuestros është caktuar me vendim të gjykatës së shkallës së parë dhe është disponuar në kontekst të një hetimi penal kompleks që përfshin disa vepra penale, ndaj ndërhyrja konsiderohet në raport të drejtë me gjendjen që e ka diktuar atë dhe me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal.

32. Nga ana tjetër, Kolegji vë në dukje se kërkuesit i është dhënë mundësia për të paraqitur çështjen e tij në procedura kontradiktore përpara gjykatave të zakonshme, të cilat i kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij për caktimin e masës së kundërshtuar, arsyetim ky që nuk duket të jetë arbitrar ose të mos plotësojë kërkesat e një gjykimi të drejtë.

33. Nën dritën e sa më sipër, Kolegji çmon se kufizimi i së drejtës së pronës së kërkuesit mbi pasurinë në fjalë është në përputhje me ligjin, është bërë për interes publik dhe respekton kriteret e proporcionalitetit, ndaj pretendimi i tij për cenimin e kësaj të drejte është haptazi i pabazuar. Rrjedhimisht edhe pretendimet e tij për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspekt të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara.

34. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “b” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.